

**VENDIM**  
**Nr. 164, datë 22.10.2020**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR  
MONITORIMIN E TREGUT TË GAZIT NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 114/1 prot., datë 16.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Draftregullat për monitorimin e tregut të gazit natyror u hartuan si dokument bazuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe përcaktojnë mënyrën dhe procedurat për monitorimin e funksionimit të tregut të gazit natyror, si dhe veprimtari të caktuara të operatorëve të transmetimit dhe të shpërndarjes për funksionimin e tregut të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë.

- Monitorimi dhe kontrolli i funksionimit të tregut të gazit natyror realizohet nga Enti Rregullator i Energjisë dhe ka për qëllim rritjen e eficiencës, konkurrencës dhe transparencës së tregut të gazit natyror, si dhe identifikimin e parregullsive.

- Monitorimi i funksionimit të tregut të gazit natyror ka të bëjë me mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe të informacionit, si dhe publikimin e informacionit sipas nenit 3, të këtyre draftregullave.

- Të gjithë pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror (tregtarët, furnizuesit, mundësisë së fundit, operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit, si dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi të licencuarit në depozitim apo operim GNL, duhet të informojnë periodikisht në lidhje me numrin e klientëve, si dhe kategorizimin e tyre sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

- Kjo draftregullore parashikon detyrimet e të licencuarit në veprimtaritë e transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit, të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për të përcjellë në ERE të dhënat dhe informacionet e nevojshme në lidhje me cilësinë e sigurimit të shërbimeve tregtare.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror” në Shqipëri.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**Petrit Ahmeti**